



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 1784/14 prot.

Pogradec, më 05 05 2026

VENDIM

Nr. 61, DATË 30 / 04 / 2026

PER MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA, PËR VENDOSJEN ANTENE TË TELEFONISË TË LËVIZSHME NË FAVOR TE KOMPANIVE ONE ALBANIA SH.A NË SIPËRFAQE, 160 M2 NE PASURINE 665 ZK 2042 KALIVAÇ, TREBINJE DHE DHE VODAFON ALBANIA SH.A SIPERFAQEN 100 M2 NE PASURINE 213/6 ZK 3753 VËRRI PROPTISHT.

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave, Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtarive ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie me qira, për vendosje antene të telefonise së levizeshme, në favor të kompanive One Albania Sh.a në sipërfaqe, 160 m2 në pasurine 665 zk 2042 Kalivaç, Trebinje dhe dhe Vodafon Albania Sh.a sipërfaqen 100 m2 në pasurine 213/6 zk 3753 Vërrri Proptisht,
2. Afati i dhenies me qera të jete deri në 10 vite, me të drejte ripertëritje, sipas periudhes të përcaktuar në projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit..
3. Në referim të bazës ligjore të sipercituar, ky proces të kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per



percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "

4. Tarifat për dhënien me qera të kesaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "7", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
5. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 25 vota

2.Vota Pro 25

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 30.04.2026